

LIGJ
Nr. 91/2022

**PËR ADERIMIN NË INICIATIVËN E PËRBASHKËT PËR RREGULLOREN
E BRENDSHME PËR SHËRBIMET TË ORGANIZATËS BOTËRORE TË
TREGTISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2, dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në iniciativën e përbashkët për Rregulloren e Brendshme për Shërbimet të Organizatës Botërore të Tregtisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 3, datë 9.1.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

INICIATIVA E PËRBASHKËT PËR RREGULLORET E BRENDSHME PËR SHËRBIMET

KOMUNIKIMI NGA SHQIPËRIA

Skeduli i para finalizimit të angazhimeve specifike

Komunikimi i mëposhtëm i datës 22 nëntor 2021 është marrë nga delegacioni i Republikës së Shqipërisë.

1. Shqipëria paraqet projektin e Skedulit bashkëlidhur si kontribut në finalizimin e negociatave në Iniciativën e Përbashkët për Rregulloren e Brendshme për Shërbimet.

2. Ky skedul pasqyron qasjen e planit të Shqipërisë në përputhje me Seksionin I të dokumentit INF/SDR/1.

SKEDULI I PARA- FINALIZIMIT TË ANGAZHIMEVE SPECIFIKE – SHQIPËRIA

Mënyrat e furnizimit: (1) Furnizimi ndërkufitar (2) Konsumi jashtë vendit (3) Prania tregtare (4) Prania e personave fizikë

Sektori ose Nënsektori	Kufizimet në qasjen në treg	Kufizimet në trajtimin kombëtar	Angazhime shtesë
I. ANGAZHIMET HORIZONTALE			
TË GJITHË SEKTORËT E PËRFSHIRË NË KËTË SKEDUL			Shqipëria ndërmerr si angazhime shtesë disiplinat e përfshira në Seksionin II të Dokumentit referues për Rregulloren e Brendshme për Shërbimet INF/SDR/1 për të gjithë sektorët e përfshirë në këtë skedul, me përjashtim të shërbimeve financiare. Shqipëria ndërmerr si angazhime shtesë disiplinat e përfshira në Seksionin III të dokumentit INF/SDR/1 për sektorët e shërbimeve financiare të përfshira në këtë skedul.



**DEKLARATË PËR PËRMBYLLJEN E NEGOCIATAVE PËR
RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHËRBIMET**

Kjo Deklaratë publikohet me kërkesë të Shqipërisë; Argjentinës; Australisë; Mbretërisë së Bahreinit; Brazilit; Kanadasë; Kilit; Kinës; Kolumbisë; Kosta Rikës; El Salvadorit; Bashkimit Evropian; Hong Kongut në Kinë; Islandës; Izraelit; Japonisë; Kazakistanit; Republikës së Koresë; Lihtenshtajnit; Mauritiusit; Meksikës; Republikës së Moldavisë; Malit të Zi; Zelandës së Re; Nigerisë; Maqedonisë së Veriut; Norvegjisë; Paraguait; Perusë; Filipineve; Federatës Ruse; Mbretërisë së Arabisë Saudite; Singaporit; Zvicrës; Territorit të Veçantë Doganor të Tajvanit, Penghut, Kinmenit dhe Matsusë; Tajlandës; Turqisë; Ukrainës; Mbretërisë së Bashkuar; Shteteve të Bashkuara të Amerikës; Uruguait.

1. Anëtarët e mëposhtëm të Organizatës Botërore të Tregtisë ("OBT")

Shqipëria
Argjentina
Australia
Mbretëria e Bahreinit
Brazili
Kanadaja
Kili
Kina
Kolumbia
Kosta Rika
El Salvadori
Bashkimi Evropian
Hong Kongu, Kinë
Islanda
Izraeli
Japonia
Kazakistani
Republika e Koresë
Lihtenshtajni,
Mauritiusi
Meksikë
Republika e Moldavisë

Mali i Zi
Zelanda e Re
Nigeria
Maqedonia e
Veriut
Norvegjia
Paraguai
Peruja
Filipinet
Federata Ruse
Mbretëria e Arabisë Saudite
Singapori
Zvicra
Territori i Veçantë Doganor i Tajvanit,
Penghu, Kinmen dhe Matsu
Tajlanda
Turqia
Ukraina
Mbretëria e Bashkuar
Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Uruguai

në vijim të referuar si "Pjesëmarrësit",

në vazhdimësi të angazhimit të shpallur më datë 13 dhjetor 2017 në sesionin e 11-të të Konferencës Ministeriale të Organizatës Botërore të Tregtisë (WT/MIN(17)/61) dhe të rikonfirmuar në datën 23 maj 2019 (WT/L/1059), dhe nga vlerësimi i vazhdueshëm i rëndësisë së praktikës së mirë rregullatore në lehtësimin e tregtisë së shërbimeve,

me anë të këtij dokumenti shpallim mbylljen e suksesshme të negociatave për Iniciativën e Përbashkët për Rregulloren e Brendshme për Shërbimet.

2. Pjesëmarrësit theksojnë mbylljen e negociatave për Dokumentin e Referencës për Rregulloren e Brendshme për Shërbimet (INF/SDR/2, datë 26 nëntor 2021, Shtojca 1).
 3. Pjesëmarrësit mirëpresin Skedulet e Angazhimeve Specifike (INF/SDR/3/Rev.1 të datës 2 dhjetor 2021, Shtojca 2) të cilat janë dorëzuar si kontributet e tyre për të finalizuar negociatat.
 4. Pjesëmarrësit synojnë të përfshijnë disiplinat në Dokumentin e Referencës si angazhime shtesë në Skedulet e tyre GATS, në përputhje me Seksionin I të Dokumentit të Referencës.
 5. Në bazë të përfundimit të çdo procedure të nevojshme të brendshme, Pjesëmarrësit synojnë të dorëzojnë për certifikim Skedulet e tyre të Angazhimeve Specifike, në përputhje me Procedurat për Certifikimin e Korrigjimeve ose Përmirësimeve të Skeduleve të Angazhimeve Specifike (S/L/84 të datës 14 prill 2000), brenda dymbëdhjetë muajve nga data e kësaj Deklarate.
 6. Brenda gjashtë muajve nga data e kësaj Deklarate, Pjesëmarrësit synojnë të mblidhen për të siguruar një përditësim mbi progresin e tyre në plotësimin e çdo procedure të kërkuar vendase dhe të vlerësojnë nëse Skedulet e tyre të Angazhimeve Specifike mund të dorëzohen për certifikim më herët se afati kohor i specifikuar në paragrafin 5.
 7. Pjesëmarrësit mirëpresin çdo anëtar tjetër të OBT-së që t'i bashkohet kësaj Deklarate, me qëllim përfshirjen e disiplinave në Dokumentin e Referencës si angazhime shtesë në Skedulin GATS përkatës, në përputhje me Seksionin I të Dokumentit të Referencës.
-

SHTOJCA 1



WORLD TRADE
ORGANIZATION

INF/SDR/2

26 nëntor 2021

(21- 8948)

Faqja: 1/12

INICIATIVA E PËRBASHKËT PËR RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHËRBIMET

DOKUMENTI I REFERENCËS PËR RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHËRBIMET

DOKUMENTI I REFERENCËS PËR RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHËRBIMET

SEKSIONI I

1. Anëtarët kanë rënë dakord për disiplinat në Rregulloren e Brendshme për Shërbimet në këtë Dokument Reference ("disiplinat"), me qëllim që të shtjellohen dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve ("Marrëveshja"), në përputhje me paragrafin 4 të Nenit VI të Marrëveshjes¹.
2. Anëtarët njohin vështirësitë me të cilat mund të përballen ofruesit e shërbimeve, veçanërisht ato të vendeve anëtare në zhvillim, në përputhje me masat në lidhje me kërkesat dhe procedurat e licencimit, kërkesat dhe procedurat e kualifikimit dhe standardet teknike të anëtarëve të tjerë dhe në veçanti, vështirësitë specifike me të cilat mund të përballen ofruesit e shërbimeve nga vendet anëtare më pak të zhvilluara.
3. Anëtarët njohin të drejtën për të rregulluar dhe për të prezantuar rregullore të reja për ofrimin e shërbimeve brenda territorit të tyre në mënyrë që të përmbushin objektivat e tyre të politikave.
4. Anëtarët njohin më tej ekzistencën e asimetrive në lidhje me shkallën e hartimit të rregulloreve të shërbimeve në vende të ndryshme, veçanërisht në rastin e vendeve anëtare në zhvillim dhe të atyre më pak të zhvilluara.
5. Disiplinat nuk do të interpretohen sikur përshkruajnë ose vendosin ndonjë dispozitë të veçantë rregullore në lidhje me zbatimin e tyre.
6. Disiplinat nuk do të interpretohen sikur reduktojnë detyrimet e Anëtarëve sipas Marrëveshjes.

Mbulimi Sektorial dhe Modalitetet e Planifikimit

7. Anëtarët i përfshijnë disiplinat në seksionin II në Skedulet e tyre si angazhime shtesë sipas nenit XVIII të Marrëveshjes. Anëtarët mund të zgjedhin të përfshijnë disiplinat alternative në Seksionin III për angazhimet e tyre në shërbimet financiare.
8. Disiplinat e parashikuara në përputhje me paragrafin 7 të këtij seksioni zbatohen kur ndërmerren angazhime specifike. Gjithashtu, anëtarët inkurajohen të përfshijnë të përcaktuara në skedulet e tyre sektorë shtesë për të cilët zbatohen disiplinat.
9. Anëtarët mund të përjashtojnë disiplinën e përcaktuar në paragrafin 22 (d) të Seksionit II dhe paragrafin 19 (d) të Seksionit III nga angazhimet shtesë të planifikuara sipas paragrafit 7 të këtij Seksioni.

Zhvillimi

Periudhat kalimtare për vendet anëtare në zhvillim

10. Një vend anëtar në zhvillim mund të caktojë disiplina specifike për zbatim në një datë pas një periudhe kalimtare jo më të gjatë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të këtyre disiplinave. Qëllimi i përcaktimit mund të kufizohet në sektorë ose nënsektorë të shërbimeve individuale. Periudhat kalimtare do të përfshihen të përcaktuara në Skedulet përkatëse të angazhimeve specifike. Një vend anëtar në zhvillim që kërkon një periudhë kalimtare të zgjatur për zbatim duhet të paraqesë një kërkesë në përputhje me procedurat përkatëse.² Anëtarët duhet të konsiderojnë me qasje dashamirëse plotësimin e kërkesave të tilla, duke marrë parasysh rrethanat specifike të anëtarit që paraqet kërkesën.

¹ Anëtarët pranojnë se disiplina të tjera mund të zhvillohen në përputhje me paragrafin 4 të nenit VI të Marrëveshjes.

² Procedurat përkatëse përfshijnë kërkesat për heqjen dorë në përputhje me paragrafin 3 (b) të nenit IX të Marrëveshjes së Marakeshit ose thirrjen e parashikuar sipas nenit XXI të GATT.

Pjesëmarrja e vendeve anëtarëve më pak të zhvilluara

11. Vendet anëtare më pak të zhvilluara do të përfshijnë të përcaktuara disiplinat në përputhje me paragrafin 7 të këtij seksioni në Skedulet e tyre të angazhimeve specifike, jo më vonë se 6 muaj para marrjes së statusit të përmbushjes së tyre të objektivave nga statusi i vendit më pak të zhvilluar. Vende anëtare më pak të zhvilluara, në kohën e parashikuar, mund të caktojnë periudha kalimtare në përputhje me paragrafin 10 të këtij seksioni. Megjithatë, vendet anëtare më pak të zhvilluara inkurajohen t'i zbatojnë këto disiplina përpara përcaktimit të statusit që kanë përmbushur objektivat, në masën që është në përputhje me kapacitetin e tyre individual të zbatimit.

Asistenca Teknike dhe Zhvillimi i Kapaciteteve

12. Vendet Anëtare të zhvilluara dhe ato në zhvillim, në gjendje ta kryejnë këtë, inkurajohen që të ofrojnë asistencë teknike specifike dhe zhvillim kapacitetesh për vendet anëtare në zhvillim dhe veçanërisht ato më pak të zhvilluara, me kërkesën e tyre dhe me terma dhe kushte të rëna dakord reciprokisht, me fokus, ndër të tjera, në:
 - a zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe rregullatore për të rregulluar ofrimin e shërbimeve dhe për të zbatuar këto disiplina, veçanërisht dispozitat dhe sektorët për të cilët zbatohen periudhat kalimtare;
 - b ofrimin e asistencës ndaj ofruesve të shërbimeve të vendeve anëtare në zhvillim dhe veçanërisht të vendeve më pak të zhvilluara për të përmbushur kërkesat dhe procedurat përkatëse në tregjet e eksportit;
 - c lehtësimin e vendosjes së standardeve teknike dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së vendeve anëtare në zhvillim dhe veçanërisht të vendeve më pak të zhvilluara që përballen me kufizime të burimeve në organizatat ndërkombëtare përkatëse; dhe
 - d ofrimin e asistencës, nëpërmjet organeve publike ose private dhe organizatave ndërkombëtare përkatëse, ofruesit e shërbimeve të vendeve anëtare në zhvillim dhe veçanërisht të vendeve më pak të zhvilluara në ndërtimin e kapaciteteve të tyre të ofrimit dhe në përputhje me rregulloret e brendshme.

SEKSIONI II – DISIPLINAT E RREGULLOREVE TË BRENDSHME TË SHËRBIMEVE

Objekti i Disiplinave

1. Këto disiplina zbatohen për masat nga anëtarët në lidhje me kërkesat dhe procedurat e liçencimit, kërkesat dhe procedurat e kualifikimit dhe standardet teknike që ndikojnë në tregtimin e shërbimeve.
2. Këto disiplina nuk zbatohen për asnjë kusht, kufizim, afat ose kualifikim të përcaktuar në Skedulin e një anëtari në përputhje me nenet XVI ose XVII të Marrëveshjes.
3. Për qëllimin e këtyre disiplinave, "autorizim" nënkupton lejen për të ofruar një shërbim që rezulton nga një procedurë së cilës një aplikant duhet t'i përmbahet, për të vërtetuar përputhshmërinë me kërkesat e liçencimit, kualifikimit ose standardet teknike.

Dorëzimi i Aplikimeve

4. Çdo Anëtar do të shmangë, në masën që është e mundur, t'i kërkojë një aplikanti që t'i drejtohet më shumë se një autoriteti kompetent për çdo aplikim për autorizim. Nëse një shërbim është brenda juridiksionit të autoriteteve të shumta kompetente, mund të kërkojen aplikime të shumta për dhënie autorizimi.

Afatet Kohore të Kërkesës

5. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, ai do të garantojë që autoritetet e tij kompetente, në masën që është e mundur të lejojnë paraqitjen e një aplikimi në çdo kohë gjatë gjithë vitit.³ Nëse ekziston një periudhë specifike kohore për aplikimin, Anëtari duhet të garantojë që autoritetet kompetente të parashikojnë një periudhë të arsyeshme për paraqitjen e një aplikimi.

Aplikimet Elektronike dhe Pranimi i Kopjeve

6. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, ai duhet të garantojë që autoritetet e tij kompetente të veprojnë si më poshtë:
 - (a) në konsideratë të prioritetit të tyre konkurruese dhe kufizimeve të burimeve, të synojnë të pranojnë aplikimet në formë elektronike; dhe
 - (b) të pranojnë kopje të dokumenteve, të cilat janë të certifikuara në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme të Anëtarit, në vend të dokumenteve origjinale, përveç rasteve kur autoritetet kompetente parashikojnë depozitimin e dokumenteve origjinale për të mos cenuar integritetin e procesit të autorizimit.

Përpunimi i Aplikimeve

7. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, ai duhet të garantojë që autoritetet e tij kompetente të veprojnë si më poshtë:
 - (a) në masën që është e mundur, të cilësojë një afat kohor të përcaktuar për përpunimin e një aplikimi;
 - (b) me kërkesë të aplikuesit, të sigurojë pa vonesë të panevojshme informacionin në lidhje me statusin e aplikimit;
 - (c) në masën që është e mundur, të konstatojë pa vonesa të panevojshme plotësimin në tërësi të një aplikimi për përpunim sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të

³ Autoriteteve kompetente nuk u kërkohet të fillojnë shqyrtimin e aplikimeve jashtë orarit dhe ditëve të tyre zyrtare të punës.

Anëtarit;

- (d) nëse autoritetet e konsiderojnë një aplikim të plotë për t'u përpunuar sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të Anëtarit⁴, brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas dorëzimit të aplikimit të sigurojnë që:
- i. ka përfunduar përpunimi i aplikimit; dhe
 - ii. aplikanti informohet për vendimin në lidhje me aplikimin⁵, në masën që është e mundur me njoftim me shkrim;⁶
- (e) nëse një aplikim konsiderohet i paplotë për t'u përpunuar në bazë të ligjeve dhe rregulloreve lokale të anëtarit brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në masën që është e mundur:
- (i) të informohet aplikanti se aplikimi është i paplotë;
 - (ii) me kërkesë të aplikantit, të identifikohet informacioni shtesë i parashikuar për t'u plotësuar tek aplikimi, ose të jepen udhëzime në rast se aplikimi konsiderohet i paplotë; dhe
 - (iii) t'i ofrohet mundësia⁷ aplikantit për të dhënë informacionin shtesë që kërkohet për të plotësuar aplikimin;
- megjithatë, nëse asnjë nga opsionet më sipër nuk është i mundur, dhe aplikimi refuzohet për shkak të mungesave në plotësim, të sigurohet informimi i aplikantit brenda një periudhe të arsyeshme kohore; dhe
- (f) nëse një aplikim refuzohet, në masën që është e mundur, me iniciativën e tyre ose me kërkesë të aplikantit, të informojë aplikantin për arsyet e refuzimit dhe, nëse është e zbatueshme, procedurat për ridorëzimin e një aplikimi; një aplikant nuk duhet të pengohet të paraqesë një aplikim tjetër⁸ vetëm në bazë të një aplikimi të refuzuar më parë.

8. Autoritetet kompetente të një anëtar do të sigurojnë që autorizimi, pasi të jetë dhënë, të hyjë në fuqi pa vonesa të panevojshme, në bazë të afateve dhe kushteve të zbatueshme.⁹

Tarifat

9. Çdo Anëtar do të sigurojë që tarifat e autorizimit¹⁰ të vendosura nga autoritetet e tij kompetente të jenë të arsyeshme, transparente, të bazuara në autoritetin e përcaktuar në masat e vendosura dhe nuk kufizojnë në vetvete ofrimin e shërbimit përkatës.

Vlerësimi i Kualifikimeve

10. Nëse një Anëtar kërkon një shqyrtim për autorizimin për ofrimin e një shërbimi, ai Anëtar garanton se autoritetet e tij kompetente e planifikojnë këtë shqyrtim në intervale të shpeshta në mënyrë të arsyeshme dhe garantojnë një periudhë të arsyeshme kohore për t'i mundësuar

⁴ Autoritetet kompetente mund të kërkojnë që i gjithë informacioni të dorëzohet në një format të caktuar për ta konsideruar atë "të plotë për përpunim".

⁵ Autoritetet kompetente mund ta përmbushin këtë kërkesë duke informuar paraprakisht me shkrim aplikantin, duke përfshirë një masë të publikuar, se mungesa e përgjigjes pas një periudhe të caktuar kohore duke filluar nga data e paraqitjes së një aplikimi, specifikon nëse aplikimi është pranuar apo refuzuar.

⁶ "Me shkrim" mund të përfshijë formën elektronike.

⁷ Kjo mundësi nuk kërkon që një autoritet kompetent të ofrojë zgjatjen e afateve.

⁸ Autoritetet kompetente mund të kërkojnë që të rishikohet përmbajtja e këtij aplikimi.

⁹ Autoritetet kompetente nuk janë përgjegjëse për vonesat për shkaqe që janë jashtë kompetencës së tyre.

¹⁰ Tarifat e autorizimit nuk përfshijnë tarifat për përdorimin e burimeve natyrore, pagesat për ankand, tenderim ose mjete të tjera jodiskriminuese të dhënies së koncesioneve ose kontributeve të mandatuar për ofrimin e shërbimit universal.

aplikantëve të kërkojnë që të kryhet shqyrtimi. Duke pasur në konsideratë koston, barrën administrative dhe integritetin e procedurave të përfshira, anëtarët inkurajohen të pranojnë kërkesat në formë elektronike për të kryer shqyrtime të tilla dhe të marrin në konsideratë, në masën që është praktike, përdorimin e mjeteve elektronike në aspekte të tjera të proceseve të shqyrtimit.

Njohja

11. Në rastet kur organet profesionale të anëtarëve janë reciprokisht të interesuar në vendosjen e dialogut për çështjet që lidhen me njohjen e kualifikimeve profesionale, liçencimin ose regjistrimin, anëtarët përkatës duhet të konsiderojnë inkurajimin e dialogut të atyre organeve në rastet kur kërkohet dhe është e përshtatshme.

Pavarësia

12. Nëse një Anëtar miraton ose ruan masa në lidhje me autorizimin për ofrimin e një shërbimi, Anëtari garanton se autoritetet e tij kompetente i marrin dhe i administrojnë vendimet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo ofrues i shërbimit për të cilin nevojitet autorizimi.¹¹

Publikimi dhe Informacioni në dispozicion

13. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, sipas Nenit III të Marrëveshjes, Anëtari publikon menjëherë,¹² ose ndryshe publikon me shkrim informacionin e nevojshëm për ofruesit e shërbimeve ose personat që kërkojnë të ofrojnë një shërbim në përputhje me kërkesat dhe procedurat për marrjen, mbajtjen, ndryshimin dhe rinovimin e këtij autorizimi. Ky informacion përfshin, ndër të tjera, aty ku ekziston:

- (a) kërkesat dhe procedurat;
- (b) të dhënat e kontaktit të autoriteteve kompetente përkatëse;
- (c) tarifat;
- (d) standardet teknike;
- (e) procedurat për apelim ose rishikim të vendimeve në lidhje me aplikimet;
- (f) procedurat për monitorimin ose zbatimin e përpunshmërisë me kushtet dhe afatet e liçencave ose kualifikimeve;
- (g) mundësitë për përfshirjen e publikut, si për shembull nëpërmjet seancave dëgjimore ose komenteve; dhe
- (h) afatet kohore treguese për përpunimin e një aplikimi.

Mundësia për të bërë komente dhe për të marrë informacion para hyrjes në fuqi

14. Në masën që e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar¹³ publikon paraprakisht:
 - (a) ligjet dhe rregulloret e tij për zbatim të përgjithshëm që propozon të miratohen në lidhje me çështjet që përfshihen në objektin e paragrafit 1 të këtij seksioni; ose

¹¹ Për siguri më të madhe, kjo dispozitë nuk bën të detyrueshme një strukturë të veçantë administrative; i referohet procesit të vendimmarrjes dhe administrimit të vendimeve.

¹² Për qëllimet e këtyre disiplinave, "publikoj" nënkupton përfshirjen e një publikimi zyrtar si në një fletore zyrtare, ose në një faqe zyrtare interneti. Anëtarët inkurajohen të konsolidojnë publikimet elektronike në një portal të vetëm.

¹³ Në paragrafët 14 deri në 17 të këtij seksioni përcaktohet se anëtarët kanë sisteme të ndryshme për t'u konsultuar me personat e interesuar dhe anëtarët e tjerë për masa të caktuara përpara miratimit të tyre, dhe se alternativat e parashikuara në paragrafin 14 të këtij seksioni pasqyrojnë sisteme të ndryshme ligjore.

- (b) dokumentet që paraqesin detaje të mjaftueshme në lidhje me një ligj ose rregullore të re të mundshme për t'i lejuar personat e interesuar dhe anëtarët e tjerë të vlerësojnë nëse dhe si mund të preken ndjeshëm interesat e tyre.
15. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar inkurajohet të zbatojë paragrafin 14 të këtij Seksioni për procedurat dhe vendimet administrative për zbatim të përgjithshëm që ai propozon të miratohen në lidhje me çështjet që përfshihen në objektin e paragrafit 1 të këtij seksioni.
16. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar do t'iu ofrojë personave të interesuar dhe anëtarëve të tjerë një mundësi të arsyeshme për të komentuar mbi masat e propozuara ose dokumentet e publikuara sipas paragrafëve 14 ose 15 të këtij seksioni.
17. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar merr në konsideratë komentet e marra sipas paragrafit 16 të këtij seksioni.¹⁴
18. Për publikimin e një ligji ose rregulloreje të përmendur në paragrafin 14 (a) të këtij seksioni, ose përpara këtij publikimi, në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, Anëtari inkurajohet të shpjegojë qëllimin dhe arsyetimin e ligjit ose rregullores.
19. Çdo Anëtar, në masën që është e mundur, synon të ofrojë një afat kohor të arsyeshëm ndërmjet publikimit të tekstit të një ligji ose rregulloreje të përmendur në paragrafin 14 (a) të këtij seksioni dhe datës kur ofruesit e shërbimeve duhet të respektojnë ligjin ose rregulloren.

Pikat e Dorëzimit të Kërkesave

20. Çdo Anëtar mban ose ngre mekanizmat e duhur për t'iu përgjigjur kërkesave të ofruesve të shërbimeve ose personave që kërkojnë të ofrojnë një shërbim në lidhje me masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij seksioni.¹⁵ Një Anëtar mund të zgjedhë t'i trajtojë këto kërkesa ose nëpërmjet pikave të dorëzimit të kërkesave dhe pikave të kontaktit të themeluara sipas neneve III dhe IV të Marrëveshjes, ose çdo mekanizmi tjetër sipas rastit.

Standardet Teknike

21. Çdo Anëtar i inkurajon autoritetet e tij kompetente, kur miraton standardet teknike, që të miratojnë standarde teknike të hartuara përmes proceseve të hapura dhe transparente, dhe inkurajon çdo organ të caktuar për të hartuar standarde teknike, duke përfshirë organizatat përkatëse ndërkombëtare,¹⁶ që të përdorin procese të hapura dhe transparente.

Hartimi i Masave

22. Nëse një Anëtar miraton ose ruan masa në lidhje me autorizimin për ofrimin e një shërbimi, Anëtari garanton se:

- (a) këto masa bazohen në kritere objektive dhe transparente;¹⁷
- (b) procedurat janë të paanshme dhe se procedurat janë të përshtatshme për aplikantët për të provuar nëse i përmbushin kërkesat, nëse ekzistojnë kërkesa të tilla;

¹⁴ Kjo dispozitë nuk cenon vendimin përfundimtar të një Anëtari që miraton ose ruan ndonjë masë për autorizimin për ofrimin e një shërbimi.

¹⁵ Kuptohet se kufizimet e burimeve mund të jenë një faktor për të përcaktuar nëse është i përshtatshëm një mekanizëm për t'iu përgjigjur kërkesave.

¹⁶ Termi "organizata përkatëse ndërkombëtare" i referohet organeve ndërkombëtare ku anëtarësimi është i hapur për organet përkatëse të të paktën të gjithë anëtarëve të OBT-së.

¹⁷ Këto kritere mund të përfshijnë, ndër të tjera, kompetencën dhe aftësinë për të ofruar një shërbim, duke përfshirë ofrimin e shërbimit në përputhje me kërkesat rregullatore të një Anëtari, si për shembull kërkesat lidhur me shëndetin dhe mjedisin. Autoritetet kompetente mund të vlerësojnë rëndësinë që duhet t'i jepet secilit kriter.

(c) procedurat në vetvete nuk pengojnë në mënyrë të pajustificueshme përmbushjen e kërkesave; dhe

(d) këto masa nuk bëjnë dallime ndërmjet burrave dhe grave.¹⁸

SEKSIONI III - DISIPLINAT ALTERNATIVE NË RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHËRBIMET FINANCIARE

Objekti

1. Këto disiplina zbatohen për masat e anëtarëve në lidhje me kërkesat dhe procedurat e liçencimit, si dhe kërkesat dhe procedurat e kualifikimit që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve financiare, siç parashikohet në shtojcën e GATS për Shërbimet Financiare.
2. Këto disiplina nuk zbatohen për asnjë kusht, kufizim, afat ose kualifikim të përcaktuar në Skedulën e një anëtari në përputhje me nenet XVI ose XVII të Marrëveshjes.
3. Për qëllimin e këtyre disiplinave, "autorizim" nënkupton lejen për të ofruar një shërbim që rezulton nga një procedurë, të cilës një aplikant duhet t'i përmbahet për të vërtetuar përputhshmërinë me kërkesat e liçencimit ose të kualifikimit.

Afatet Kohore të Aplikimit

4. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, ai do të garantojë që autoritetet e tij kompetente, në masën që është e mundur të lejojnë paraqitjen e një aplikimi në çdo kohë gjatë gjithë vitit.¹⁹ Nëse ekziston një periudhë specifike kohore për aplikimin, Anëtari duhet të sigurojë që autoritetet kompetente të parashikojnë një periudhë të arsyeshme për paraqitjen e një aplikimi.

Aplikimet Elektronike dhe Pranimi i Kopjeve

5. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, ai duhet të garantojë që autoritetet e tij kompetente të veprojnë si më poshtë:
 - (a) në konsideratë të prioriteteve të tyre konkurruese dhe kufizimeve të burimeve, të synojnë të pranojnë aplikimet në formë elektronike; dhe
 - (b) të pranojnë kopje të dokumenteve, të cilat janë të certifikuara në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme të Anëtarit, në vend të dokumenteve origjinale, përveç rasteve kur autoritetet kompetente parashikojnë depozitimin e dokumenteve origjinale për të mos cenuar integritetin e procesit të autorizimit.

Përpunimi i Aplikimeve

6. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, ai duhet të garantojë që autoritetet e tij kompetente të veprojnë si më poshtë:
 - (a) në masën që është e mundur, të cilësojë një afat kohor të përcaktuar për përpunimin e një aplikimi;
 - (b) me kërkesë të aplikantit, të sigurojë pa vonesë të panevojshme informacionin në lidhje me statusin e aplikimit;

¹⁸ Trajtimi diferencial që është i arsyeshëm dhe objektiv dhe synon të arrijë një qëllim legjitim dhe miratimi nga anëtarët i masave të përkohshme të veçanta që synojnë përsheptimin e barazisë *de facto* midis burrave dhe grave, nuk do të konsiderohet diskriminim për qëllimet e kësaj dispozite.

¹⁹ Autoriteteve kompetente nuk u kërkohet të fillojnë shqyrtimin e aplikimeve jashtë orarit dhe ditëve të tyre zyrtare të punës.

(c) në masën që është e mundur, të konstatojë pa vonesa të panevojshme plotësinë e një aplikimi për përpunim sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të Anëtarit;

(d) nëse autoritetet e konsiderojnë një aplikim të plotë për t'u përpunuar sipas ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të Anëtarit,²⁰ brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas dorëzimit të aplikimit, të garantojnë që:

(i) ka përfunduar përpunimi i aplikimit; dhe

(ii) aplikanti informohet për vendimin në lidhje me aplikimin,²¹ në masën që është e mundur me shkrim;²²

(e) nëse një aplikim konsiderohet i paplotë për t'u përpunuar në bazë të ligjeve dhe rregulloreve lokale të anëtarit brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në masën që është e mundur:

(i) të informohet aplikanti se aplikimi është i paplotë;

(ii) me kërkesë të aplikantit, të identifikohet informacioni shtesë i parashikuar për tu plotësuar tek aplikimi, ose të jepen udhëzime në rast se aplikimi konsiderohet i paplotë; dhe

(iii) t'i ofrojë aplikantit mundësinë²³ për të dhënë informacionin shtesë që kërkohet për të plotësuar aplikimin;

megjithatë, nëse asnjë nga opsionet më sipër nuk është i mundur, dhe aplikimi refuzohet për shkak të mungesave në plotësim, të sigurohet informimi i aplikantit brenda një periudhe të arsyeshme kohore; dhe

(f) nëse një aplikim refuzohet, në masën që është e mundur, qoftë me iniciativën e tyre ose me kërkesë të aplikantit, të informojë aplikantin për arsyet e refuzimit dhe, nëse janë të zbatueshme, procedurat për ridorëzimin e një aplikimi; një aplikant nuk duhet të ndalohet që të paraqesë një aplikim tjetër²⁴ vetëm në bazë të faktit se një aplikim është refuzuar më parë.

7. Autoritetet kompetente të një anëtar garantojnë se autorizimi, pasi të jetë dhënë, të hyjë në fuqi pa vonesa të panevojshme, në bazë të kushteve dhe afateve të zbatueshme.²⁵

Tarifat

8. Çdo Anëtar garanton se autoritetet e tij kompetente iu ofrojnë aplikantëve një program tarifash ose informacionesh sesi përcaktohen shumat e tarifave për sa i takon tarifave të autorizimit²⁶ që ata vendosin.

Vlerësimi i Kualifikimeve

²⁰ Autoritetet kompetente mund të kërkojnë që i gjithë informacioni të dorëzohet në një format të caktuar për ta konsideruar atë "të plotë për përpunim".

²¹ Autoritetet kompetente mund ta përmbushin këtë kërkesë duke informuar paraprakisht me shkrim aplikantin, përfshirë një masë të publikuar, se mungesa e përgjigjes pas një periudhe të caktuar kohore duke filluar nga data e paraqitjes së një aplikimi, specifikon nëse aplikimi është pranuar apo refuzuar.

²² "Me shkrim" mund të përfshijë formën elektronike.

²³ Kjo mundësi nuk kërkon që një autoritet kompetent të ofrojë zgjatjen e afateve.

²⁴ Autoritetet kompetente mund të kërkojnë që të rishikohet përmbajtja e këtij aplikimi.

²⁵ Autoritetet kompetente nuk janë përgjegjëse për vonesat për shkaqe që janë jashtë kompetencës së tyre.

²⁶ Tarifat e autorizimit nuk përfshijnë tarifat për përdorimin e burimeve natyrore, pagesat për ankand, tenderim ose mjete të tjera jodiskriminuese të dhënies së koncesioneve ose kontributeve të mandatuara për ofrimin e shërbimit universal.

9. Nëse një Anëtar kërkon një shqyrtim për autorizimin për ofrimin e një shërbimi, ai Anëtar garanton se autoritetet e tij kompetente e planifikojnë këtë shqyrtim në intervale të shpeshta në mënyrë të arsyeshme dhe garantojnë një periudhë të arsyeshme kohore për t'i mundësuar aplikantëve të kërkojnë që të kryhet shqyrtimi. Duke pasur parasysh koston, barrën administrative dhe integritetin e procedurave të përfshira, anëtarët inkurajohen të pranojnë kërkesat në formë elektronike për të kryer këto shqyrtime dhe të marrin në konsideratë, në masën që është e mundur, përdorimin e mjeteve elektronike në aspekte të tjera të proceseve të shqyrtimit.

Pavarësia

10. Nëse një Anëtar miraton ose ruan masa në lidhje me autorizimin për ofrimin e një shërbimi, Anëtari garanton se autoritetet e tij kompetente i marrin dhe i administrojnë vendimet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo ofrues i shërbimit për të cilin nevojitet autorizimi.²⁷

Publikimi dhe Informacioni në dispozicion

11. Nëse një Anëtar kërkon autorizim për ofrimin e një shërbimi, sipas Nenit III të Marrëveshjes dhe paragrafëve 6 dhe 8 të këtij seksioni, Anëtari publikon menjëherë²⁸ ose ndryshe publikon me shkrim informacionin e nevojshëm për ofruesit e shërbimeve ose personat që kërkojnë të ofrojnë një shërbim në përputhje me kërkesat dhe procedurat për marrjen, mbajtjen, ndryshimin dhe rinovimin e këtij autorizimi. Ky informacion përfshin, ndër të tjera, aty ku ekziston:
- (a) kërkesat dhe procedurat;
 - (b) të dhënat e kontaktit të autoriteteve kompetente përkatëse;
 - (c) procedurat për apelim ose rishikim të vendimeve në lidhje me aplikimet;
 - (d) procedurat për monitorimin ose zbatimin e përputhshmërisë me kushtet dhe afatet e licencave ose kualifikimeve; dhe
 - (e) mundësitë për përfshirjen e publikut, si për shembull nëpërmjet seancave dëgjimore ose komenteve.

Mundësia për të bërë komente dhe për të marrë informacion përpara hyrjes në fuqi

12. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar²⁹ publikon paraprakisht:
- (a) ligjet dhe rregulloret e tij për zbatim të përgjithshëm që propozon që të miratohen në lidhje me çështjet që përfshihen në objektin e paragrafit 1 të këtij seksioni; ose
 - (b) dokumentet që paraqesin detaje të mjaftueshme në lidhje me një ligj ose rregullore të re të mundshme për t'i lejuar personat e interesuar dhe anëtarët e tjerë të vlerësojnë nëse dhe si mund të preken ndjeshëm interesat e tyre.
13. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar inkurajohet të zbatojë paragrafin 12 të këtij Seksioni për procedurat dhe vendimet administrative për zbatim të përgjithshëm që ai propozon të miratohen në lidhje me çështjet që përfshihen në objektin e paragrafit 1.

²⁷ Për siguri më të madhe, kjo dispozitë nuk bën të detyrueshme një strukturë të veçantë administrative; i referohet procesit të vendimmarrjes dhe administrimit të vendimeve.

²⁸ Për qëllimet e këtyre disiplinave, "publikoj" nënkupton përfshirjen e një publikimi zyrtar si në një fletore zyrtare, ose në një faqe zyrtare interneti. Anëtarët inkurajohen të konsolidojnë publikimet elektronike në një portal të vetëm.

²⁹ Në paragrafët 12 deri në 15 të këtij seksioni përcaktohet se anëtarët kanë sisteme të ndryshme për t'u konsultuar me personat e interesuar dhe anëtarët e tjerë për masa të caktuara përpara miratimit të tyre dhe se alternativat e parashikuara në paragrafin 12 të këtij seksioni pasqyrojnë sisteme të ndryshme ligjore.

14. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar do t'iu ofrojë personave të interesuar dhe anëtarëve të tjerë një mundësi të arsyeshme për të komentuar mbi masat e propozuara ose dokumentet e publikuara sipas paragrafëve 12 ose 13 të këtij seksioni.
15. Në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, çdo Anëtar merr në konsideratë komentet e marra sipas paragrafit 14 të këtij seksioni.³⁰
16. Për publikimin e një ligji ose rregulloreje të përmendur në paragrafin 12 (a) të këtij seksioni, ose para këtij publikimi, në masën që është e mundur dhe në përputhje me sistemin e tij ligjor për miratimin e masave, Anëtari inkurajohet të shpjegojë qëllimin dhe arsyetimin e ligjit ose rregullores.
17. Çdo Anëtar, në masën që sa është e mundur, synon të ofrojë një afat kohor të arsyeshëm ndërmjet publikimit të tekstit të një ligji ose rregulloreje të përmendur në paragrafin 12 (a) të këtij seksioni dhe datës kur ofruesit e shërbimeve duhet të respektojnë ligjin ose rregulloren.

Pikat e Dorëzimit të Kërkesave

18. Çdo Anëtar mban ose ngre mekanizmat e duhur për t'iu përgjigjur kërkesave të ofruesve të shërbimeve ose personave që kërkojnë të ofrojnë një shërbim në lidhje me masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij seksioni.³¹ Një Anëtar mund të zgjedhë t'i trajtojë këto kërkesa ose nëpërmjet pikave të dorëzimit të kërkesave dhe pikave të kontaktit të themeluara sipas neneve III dhe IV të Marrëveshjes, ose çdo mekanizmi tjetër sipas rastit.

Hartimi i Masave

19. Nëse një Anëtar miraton ose ruan masa në lidhje me autorizimin për ofrimin e një shërbimi, Anëtari garanton se:
 - (a) këto masa bazohen në kritere objektive dhe transparente;³²
 - (b) procedurat janë të paanshme dhe se procedurat janë të përshtatshme për aplikantët për të provuar nëse i përmbushin kërkesat, nëse ekzistojnë kërkesa të tilla;
 - (c) procedurat në vetvete nuk pengojnë në mënyrë të pajustificueshme përmbushjen e kërkesave; dhe
 - (d) këto masa nuk bëjnë dallime ndërmjet burrave dhe grave.³³

³⁰ Kjo dispozitë nuk cenon vendimin përfundimtar të një Anëtari që miraton ose ruan ndonjë masë për autorizimin për ofrimin e një shërbimi.

³¹ Kuptohet se kufizimet e burimeve mund të jenë një faktor për të përcaktuar nëse është i përshtatshëm një mekanizëm për t'iu përgjigjur kërkesave.

³² Këto kritere mund të përfshijnë, ndër të tjera, kompetencën dhe aftësinë për të ofruar një shërbim, duke përfshirë ofrimin e shërbimit në përputhje me kërkesat rregullatore të një Anëtari. Autoritetet kompetente mund të vlerësojnë rëndësinë që duhet t'i jepet secilit kriter.

³³ Trajtimi diferencial që është i arsyeshëm dhe objektiv dhe synon të arrijë një qëllim legjitim dhe miratimi nga anëtarët i masave të përkohshme të veçanta që synojnë përsheptimin e barazisë *de facto* midis burrave dhe grave, nuk do të konsiderohet diskriminim për qëllimet e kësaj dispozite.

SHTOJCA 2



INF/SDR/3/Rev.1

2 dhjetor 2021

(21- 9072)

Faqja: 1/2

INICIATIVA E PËRBASHKËT PËR RREGULLOREN E BRENDSHME PËR SHËRBIMET

PROGRAMET E ANGAZHIMEVE SPECIFIKE

*Rishikim**

Ky dokument përmban një listë të Skeduleve të Angazhimeve Specifike në lidhje me disiplinat e rregullores së brendshme për shërbimet.

	ANËTARI	DATA E DORËZIMIT	SIMBOLI I DOKUMENTIT
1.	Shqipëria	22.11.2021	INF/SDR/IDS/ALB/Rev.1
2.	Argjentina	29.10.2021	INF/SDR/IDS/ARG
3.	Australia	19.10.2021	INF/SDR/IDS/AUS/Rev.1
4.	Mbretëria e Bahreinit	Të dorëzohet jo më vonë se data 31 mars 2022	
5.	Brazili	12.11.2021	INF/SDR/IDS/BRA/Rev.1
6.	Kanadaja	22.10.2021	INF/SDR/IDS/CAN/Rev.1
7.	Kili	29.10.2021	INF/SDR/IDS/CHL/Rev.1
8.	Kina	29.10.2021	INF/SDR/IDS/CHN/Rev.1
9.	Kolumbia	29.10.2021	INF/SDR/IDS/COL/Rev.1
10.	Kosta Rika	17.11.2021	INF/SDR/IDS/CRI/Rev.1
11.	El Salvadori	Të dorëzohet jo më vonë se data 31 mars 2022	
12.	Bashkimi Evropian	29.10.2021	INF/SDR/IDS/EU/Rev.1
13.	Hong Kong, Kinë	02.11.2021	INF/SDR/IDS/HKG/Rev.1
14.	Islanda	29.10.2021	INF/SDR/IDS/ISL/Rev.1
15.	Izraeli	29.10.2021	INF/SDR/IDS/ISR/Rev.1
16.	Japonia	28.10.2021	INF/SDR/IDS/JPN/Rev.1
17.	Kazakistani	26.11.2021	INF/SDR/IDS/KAZ/Rev.1

* Ky rishikim shton El Salvadorin në listën e Programeve të Angazhimeve Specifike.

	ANËTARI	DATA E DORËZIMIT	SIMBOLI I DOKUMENTIT
18.	Republika e Koresë	28.10.2021	INF/SDR/IDS/KOR/Rev.1
19.	Lihtenshtajni	10.11.2021	INF/SDR/IDS/LIE/Rev.1
20.	Mauritiusi	27.10.2021	INF/SDR/IDS/MUS/Rev.1
21.	Meksika	01.11.2021	INF/SDR/IDS/MEX/Rev.1
22.	Republika e Moldavisë	29.10.2021	INF/SDR/IDS/MDA/Rev.1
23.	Mali i Zi	16.11.2021	INF/SDR/IDS/MNE/Rev.1
24.	Zelanda e Re	29.10.2021	INF/SDR/IDS/NZL/Rev.1
25.	Nigeria	23.11.2021	INF/SDR/IDS/NGA/Rev.1
26.	Maqedonia e Veriut	16.11.2021	INF/SDR/IDS/MDK/Rev.1
27.	Norvegjia	28.10.2021	INF/SDR/IDS/NOR/Rev.1
28.	Paraguai	19.11.2021	INF/SDR/IDS/UKR/Rev.1
29.	Peru	17.11.2021	INF/SDR/IDS/PER/Rev.1
30.	Filipine	Të dorëzohet jo më vonë se data 28 shkurt 2022	
31.	Federata Ruse	Të dorëzohet jo më vonë se data 28 shkurt 2022	
32.	Mbretëria e Arabisë Saudite	22.11.2021	INF/SDR/IDS/KSA/Rev.1
33.	Singapori	03.11.2021	INF/SDR/IDS/SGP/Rev.1
34.	Zvicra	01.11.2021	INF/SDR/IDS/CHE/Rev.1
35.	Territori i Veçantë Doganor i Tajvanit, Penghu, Kinmen dhe Matsu	27.10.2021	INF/SDR/IDS/TPKM/Rev.1
36.	Tajlanda	25.11.2021	INF/SDR/IDS/THA
37.	Turqia	28.10.2021	INF/SDR/IDS/TUR/Rev.1
38.	Ukraina	05.11.2021	INF/SDR/IDS/UKR/Rev.1
39.	Mbretëria e Bashkuar	27.10.2021	INF/SDR/IDS/GBR
40.	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	22.10.2021	INF/SDR/IDS/USA
41.	Uruguai	29.10.2021	INF/SDR/IDS/URY/Rev.1